

# Kërcënimet ndaj gazetarëve janë absolutisht të papranueshme

**Shkup, 24 korrik 2020** – Në lidhje me kërcënimet e bëra përmes rrjetit social “Facebook” drejtuar gazetares së “Sloboden Peçat”, Miroslava Brns, Agjencia e dënon dhe kujton se ndodhi të tilla jo që janë absolutisht të papranueshme, por gjithashtu paraqesin kërcënim për lirinë e informimin .

Sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, përfshirë ato të drejtuara në rrjetet sociale, janë sulm i drejtpërdrejtë ndaj demokracisë dhe lirisë së fjalës në një shoqëri.

Gazetarët punojnë në interes të publikut dhe janë një nga korigjuesit kryesorë dhe nxitësit e proceseve demokratike. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të krijohen kushte që gazetarët, pa presion, ta bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale – informimin e publikut.